REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**VENDIM**

Nr.31, datë 18.03.2024

**PËR**

**"CAKTIMIN E ZOTIT ABAZ MUÇA, NËPËRMJET PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË, NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR"**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 47 pika 6 dhe 52 të ligjit Nr.96/2016 *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar*, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa "a" të ligjit Nr.115/2016 *"Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar*, nenin 28 të Rregullores "*Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm*", si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Të caktojë zotin Abaz Muça në detyrën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
2. Zoti Abaz Muça do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër nga data 18.03.2024 – 18.03.2027.
3. Të ndërpritet caktimi i përkohshëm i zotit Abaz Muça, si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Abaz Muça, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 18.03.2024.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR**
**Alfred Balla**

**ANËTAR**
**Sokol Stojani**

**ANËTAR**
**Nurihan Seiti**

**ANËTAR**
**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**
**Mirela Bogdani**

| ANËTAR | ANËTAR | ANËTAR |
|---|---|---|
| Arta Mandro | Ledina Riza | Moisi Duda |
| ANËTAR | ANËTAR | |
| Vatë Staka | Olger Eminaj | |